TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

**FAKULTETI ADMINISTRIM BIZNESI**

# RREGULLORE
# E PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR
# NE ADMINISTRIM BIZNESI

## KREU I
## PARIMET E PËRGJITHSHME

### Neni 1
### Baza ligjore

Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Administrim Biznesi mbështetet në Ligjin nr. 80/2015 datë 22. 07. 2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", Strategjinë e Zhvillimit të TBU-së, Statutin dhe Rregulloren për Programet e Studimit dhe Proçesin Mësimor.

### Neni 2
### Objekti

Kjo rregullore përcakton organizimin e programit të studimit Bachelor ne Administrim Biznesi për të tre Profilet, Menaxhim, Kontabilitet-Financë dhe Marketing, duke respektuar legjislacionin në fuqi, lirinë akademike, të drejtat dhe detyrimet e personelit akademik dhe të studentëve.

Çdo aspekt tjetër që nuk është trajtuar në këtë rregullore do të trajtohet ashtu si përcaktohet në Rregulloren për Programet e Studimit dhe Proçesin Mësimor.

## KREU II
## ELEMENTËT E PROGRAMIT MËSIMOR

### Neni 3
### Qellimi dhe objektivat

Qëllimi i këtij programi studimi është të përgatisë administratorë të përgjithshëm apo menaxherë si edhe administratorë të profilizuar në aspekte më të veçanta si financë-kontabiliteti dhe marketingu, të paisur me njohuritë teorike dhe shprehi praktike të avancuara duke i bërë ata të aftë të kuptojnë kërkesat, kushtet dhe zhvillimet e tregut specifik ku konkurron biznesi, te mjedisit ekonomik, ligjor e social si edhe të aftë të zgjidhin probleme komplekse dhe të paparashikueshme në profilin për të cilin studjojnë.

Objektivat formues të programit Bachelor janë:

- Studenti të pajiset me njohuritë themelore dhe të avancuara për administrimin e biznesit. Njohuritë e fituara nga studenti përfaqësojnë eksperiencat e konsoliduara të fushës dhe të përshtatura edhe për kushtet e ekonomisë shqiptare. Këto njohuri i hapin rrugë mundësisë për të

zgjeruar më tej njohuritë gjatë studimeve pasuniversitare për ata që dëshirojnë t'i vazhdojnë këto studime.

- Studenti të jetë i aftë të përshtatet në tregun e punës duke zënë pozicion pune me ambicie për zhvillimin e karrierës. Studimet japin mundësinë e synimit të pozicioneve të larta në strukturat organizative të subjekteve private apo publike, atje ku kërkohet udhëheqje, drejtim, zbatim dhe vendimmarrje.

- Studenti të njihet me eksperiencat dhe praktikat e aktorëve të ekonomisë gjatë viteve të studimit nëpërmjet kryerjes së praktikave apo punësimit në kompanitë me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi.

- Objektivi kryesor i TBU është që studentët e këtij programi studimi të punësohen në pozicione që kanë lidhje me profilin e studimeve përpara përfundimit të vitit të tretë.

- Studenti të jetë konkurues për vende pune edhe në vende të tjera, në qoftë se ai/ajo dëshiron të punësohet jashtë vendit.

## Neni 4
## Programi i Studimit

a) Programi i Studimit Bachelor në Administrim Biznesi, është program i ciklit të parë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike dhe me 180 kredite (ECTS). Forma e studimit është me kohë të plotë.

b) Programi i studimit është parashikuar të realizohet në 4,500 orë, nga të cilat 1,515 orë janë orë studimi në auditor dhe 2,985 orë janë orë studimi individual.

c) Viti akademik zgjat 30 javë mësimore dhe deri në 4 javë të parashikuara për sesionet normale të provimeve. Përgjatë çdo viti akademik, studenti kryen praktikë profesionale ose pune në profilin e tij të studimeve me jo më pak se 4 javë.

d) Koha e fillimit, mbarimit, sesionet e provimeve, pushimet e festave zyrtare përcaktohen në kalendarin akademik e të miratuar nga Senati Akademik në fillim të çdo viti akademik.

## Neni 5
## Struktura e programit të studimit

Studenti që ndjek këtë program studimi duhet të përfitojë të paktën 180 kredite, nga të cilat 33 ECTS në kategorinë (A); 96 ECTS në kategorinë e disiplinave karakterizuese (B); 22 ECTS në kategorinë e lëndëve ndërdisiplinore dhe integruese si edhe lëndët me zgjedhje (C); 23 ECTS në kategorinë e lëndëve plotësuese (D); 6 ECTS detyrime përmbyllëse (E).

Ky program studimi ka tre profile, menaxhim, Kontabilitet – Financë dhe Marketing. Në tabelat vijuese jepet struktura e veprimtarive formuese e secilit profil.

## 1- Profili "MENAXHIM"

| Veprimtaritë Formuese Programi Bachelor në Administrim Biznesi<br>Profili MENAXHIM | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kategoria** | **Tipi i komponentit mësimor** | | **Lëndët** | **ECTS** |
| **A** | **Lëndë Bazë<br>(15-20%)<br>(27-36 ECTS)** | 1 | Matematikë e Përgjithshme | 6 |
| | | 2 | Statistikë e Përgjithshme | 6 |
| | | 3 | Statistikë e Aplikuar | 6 |
| | | 4 | Software Aplikative | 5 |
| | | 5 | Komunikim Profesional dhe Akademik | 10 |
| | | | **Total ECTS** | **33** |
| **B** | **Lëndë Karakterizuese<br>(50-55%)<br>(90-99 ECTS)** | | **Total ECTS (Kategori B)** | **96** |
| | **Lëndët Karakterizuese të Programit AB*** | 1 | Mikroekonomi | 5 |
| | | 2 | Makroekonomi | 5 |
| | | 3 | Anglishtja e Biznesit | 5 |
| | | 4 | Hyrje në Biznes | 5 |
| | | 5 | Parimet e Kontabilitetit | 6 |
| | | 6 | Hyrje në Financë | 5 |
| | | 7 | Bazat e Marketingut | 5 |
| | | 8 | Sjellje Organizative | 5 |
| | | 9 | Menaxhimi i Burimeve Njerëzore | 5 |
| | | 10 | Kontabilitet Drejtim Kosto | 6 |
| | | 11 | Menaxhimi Financiar | 5 |
| | | 12 | Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit | 6 |
| | | 13 | Administrimi Fiskal | 5 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | 14 | Sipërmarja dhe Menaxhimi i Biznesit të Vogëll | 6 |
| | | 15 | Menaxhim Projektesh | 6 |
| | | 16 | Menaxhimi Strategjik | 6 |
| | | 17 | Menaxhimi i Operacioneve | 6 |
| | | 18 | Etika e Biznesit | 5 |
| | | 19 | Qeverisja e Korporatave | 6 |
| | | 20 | Vlerësim Projektesh | 6 |
| | | | **Total ECTS** | **86** |
| | **Lëndë karakterizuese Profili Menaxhim**** | 1 | Menaxhimi i Cilësisë | 6 |
| | | 2 | Biznesi Ndërkombëtar | 6 |
| | | 3 | Menaxhimi i Forcës së Shitjes | 5 |
| | | 4 | Menaxhim Marketingu | 5 |
| | | 5 | Menaxhimi i Mardhënieve me Klientin | 6 |
| | | | **Total ECTS** | **10** |
| | | | **Total ECTS (Kategori A+B)** | **129** |
| **C** | **Lëndë Ndërdisiplinore/Integruese, Profilizuese, me zgjedhje (12-15%) (21.6 -27 ECTS)** | 1 | E Drejtë Biznesi | 6 |
| | | 2 | Matematika e Aplikuar | 6 |
| | | 3 | Lëndë me zgjedhje*** | 5 |
| | | 4 | Lëndë me zgjedhje*** | 5 |
| | | | **Total ECTS** | **22** |
| **D** | **Lende Plotesuese (10-15%) (18 -27 ECTS)** | 1 | Anglishtja e Përgjithshme | 4 |
| | | 2 | Hyrje në Informatikë | 4 |
| | | 3 | Praktika Profesionale/Seminar Special | 15 |
| | | | **Total ECTS** | **23** |
| **E** | **Detyrime Përmbyllëse (3-5%) (5.4 - 9 ECTS)** | | **Temë Diplome/Provim i Përgjithshëm Përfundimtar** | **6** |
| **Gjithsej 29 Lende** | | | **Profili Menaxhim Total ECTS** | **180** |

| |
|---|
| * Nga lëndët e renditura në grupin prej renditjes 15 deri në 20, të cilat janë lëndë që ofrohen në vitin e tretë, për çdo vit akademik do të ofrohen vetëm 2 prej tyre. Kjo përcaktohet në planet mësimore që përgatiten çdo vit akademik, ku njësitë bazë përgjegjëse për këtë program studimi përcaktojnë lëndët që do të ofrohen duke pasur parasysh edhe lëndët që do të ofrohen në programet master të fakultetit Administrim Biznesi. |
| ** Çdo student do të kryejë dy lëndë nga kjo kategori. |
| *** Si lëndë me zgjedhje, përveç lëndëve karakterizuese të këtij programi e të këtij profili, do të shërbejnë edhe lëndët karakterizuese të dy profileve të tjera. Njera nga këto lëndë me zgjedhje mund të jetë edhe nga programi Bachelor "E drejtë Biznesi". |

## 2- Profili “KONTABILITET– FINANCË”

| Veprimtaritë Formuese Programi Bachelor në Administrim Biznesi<br>Profili KONTABILITET-FINANCE | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kategoria** | **Tipi i komponentit mësimor** | | **Lëndët** | **ECTS** |
| **A** | **Lëndë Bazë<br>(15-20%)<br>(27-36 ECTS)** | 1 | Matematikë e Përgjithshme | 6 |
| | | 2 | Statistikë e Përgjithshme | 6 |
| | | 3 | Statistikë e Aplikuar | 6 |
| | | 4 | Software Aplikative | 5 |
| | | 5 | Komunikim Profesional dhe Akademik | 10 |
| | | | **Total ECTS** | **33** |
| **B** | **Lëndë Karakterizuese<br>(50-55%)<br>(90-99 ECTS)** | | **Total ECTS (Kategori B)** | **96** |
| | **Lëndët karakterizuese të Programit AB*** | 1 | Mikroekonomi | 5 |
| | | 2 | Makroekonomi | 5 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | 3 | Anglishtja e Biznesit | 5 |
| | | 4 | Hyrje në Biznes | 5 |
| | | 5 | Parimet e Kontabilitetit | 6 |
| | | 6 | Hyrje në Financë | 5 |
| | | 7 | Bazat e Marketingut | 5 |
| | | 8 | Sjellje Organizative | 5 |
| | | 9 | Menaxhimi i Burimeve Njerëzore | 5 |
| | | 10 | Kontabilitet Drejtim Kosto | 6 |
| | | 11 | Menaxhimi Financiar | 5 |
| | | 12 | Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit | 6 |
| | | 13 | Administrimi Fiskal | 5 |
| | | 14 | Sipërmarja dhe Menaxhimi i Biznesit të Vogëll | 6 |
| | | 15 | Menaxhim Projektesh | 6 |
| | | 16 | Menaxhimi Strategjik | 6 |
| | | 17 | Menaxhimi i Operacioneve | 6 |
| | | 18 | Etika e Biznesit | 5 |
| | | 19 | Qeverisja e Korporatave | 6 |
| | | 20 | Vlerësim Projektesh | 6 |
| | | | **Total ECTS** | **86** |
| | **Lëndë karakterizuese Profili Kontabilitet-Financë**** | 1 | Kontabilitet Financiar | 6 |
| | | 2 | Hyrje në Auditim | 5 |
| | | 3 | Teknika Bankare | 5 |
| | | 4 | Tregje dhe Institucione Financiare | 6 |
| | | 5 | Ekonomia Monetare | 6 |
| | | 6 | Investimet | 5 |
| | | | **Total ECTS** | **10** |
| | | | **Total ECTS (Kategori A+B)** | **129** |
| **C** | **Lëndë Ndërdisiplinore/Integruese,** | 1 | E Drejtë Biznesi | 6 |
| | | 2 | Matematikë e Aplikuar | 6 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **Profilizuese, me zgjedhje (12-15%) (21.6 -27 ECTS)** | 3 | Lëndë me zgjedhje*** | 5 |
| | | 4 | Lëndë me zgjedhje*** | 5 |
| | | | **Total ECTS** | **22** |
| **D** | **Lëndë Plotësuese (10-15%) (18 -27 ECTS)** | 1 | Anglishtja e Përgjithshme | 4 |
| | | 2 | Hyrje në Informatike | 4 |
| | | 3 | Praktika Profesionale/Seminar Special | 15 |
| | | | **Total ECTS** | **23** |
| **E** | **Detyrime Përmbyllëse (3-5%) (5.4 - 9 ECTS)** | | Temë Diplome/ Provim i Përgjithshëm Përfundimtar | **6** |
| **Gjithsej 29 Lëndë** | | | **Profili Kontabilitet Financë Total ECTS** | **180** |

* Nga lëndët e renditura në grupin prej renditjes 15 deri në 20, të cilat janë lëndë që ofrohen në vitin e tretë, për çdo vit akademik do të ofrohen vetëm 2 prej tyre. Kjo përcaktohet në planet mësimore që përgatiten çdo vit akademik, ku njësitë bazë përgjegjëse për këtë program studimi përcaktojnë lëndët që do të ofrohen duke pasur parasysh edhe lëndët që do të ofrohen në programet master të fakultetit Administrim Biznesi.

** Çdo student do të kryejë dy lëndë nga kjo kategori.

*** Si lëndë me zgjedhje, përveç lëndëve karakterizuese të këtij programi e të këtij profili, do të shërbejnë edhe lëndët karakterizuese të dy profileve të tjera. Njera nga këto lëndë me zgjedhje mund të jetë edhe nga programi Bachelor "E drejtë Biznesi"

## 3- Profili "MARKETING"

TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| Veprimtaritë Formuese Programi Bachelor në Administrim Biznesi Profili MARKETING | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kategoria** | **Tipi i komponentit mësimor** | | **Lëndët** | **ECTS** |
| **A** | **Lëndë Bazë (15-20%) (27-36 ECTS)** | 1 | Matematikë e Përgjithshme | 6 |
| | | 2 | Statistikë e Përgjithshme | 6 |
| | | 3 | Statistikë e Aplikuar | 6 |
| | | 4 | Software Aplikative | 5 |
| | | 5 | Komunikim Profesional dhe Akademik | 10 |
| | | | **Total ECTS** | **33** |
| **B** | **Lëndë Karakterizuese (50-55%) (90-99 ECTS)** | | **Total ECTS (Kategori B)** | **96** |
| | **Lëndët karakterizuese të Programit AB*** | 1 | Mikroekonomi | 5 |
| | | 2 | Makroekonomi | 5 |
| | | 3 | Anglishtja e Biznesit | 5 |
| | | 4 | Hyrje në Biznes | 5 |
| | | 5 | Parimet e Kontabilitetit | 6 |
| | | 6 | Hyrje në Financë | 5 |
| | | 7 | Bazat e Marketingut | 5 |
| | | 8 | Sjellje Organizative | 5 |
| | | 9 | Menaxhimi i Burimeve Njerëzore | 5 |
| | | 10 | Kontabilitet Drejtim Kosto | 6 |
| | | 11 | Menaxhimi Financiar | 5 |
| | | 12 | Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit | 6 |
| | | 13 | Administrimi Fiskal | 5 |
| | | 14 | Sipërmarja dhe Menaxhimi i Biznesit të Vogëll | 6 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | 15 | Menaxhim Projektesh | 6 |
| | | 16 | Menaxhimi Strategjik | 6 |
| | | 17 | Menaxhimi i Operacioneve | 6 |
| | | 18 | Etika e Biznesit | 5 |
| | | 19 | Qeverisja e Korporatave | 6 |
| | | 20 | Vlerësim Projektesh | 6 |
| | | | **Total ECTS** | **86** |
| | **Lëndë karakterizuese Profili Marketing**** | 1 | Menaxhim Marketingu | 5 |
| | | 2 | Menaxhimi i Forcës së Shitjes | 5 |
| | | 3 | Menaxhim Promocioni | 5 |
| | | 4 | Kërkim Tregu | 5 |
| | | 5 | Menaxhimi Strategjik i Marketingut | 6 |
| | | 6 | Menaxhimi Strategjik i Markës | 6 |
| | | 7 | Marketingu i Shërbimeve | 5 |
| | | 8 | Sjellja Konsumatore | 5 |
| | | 9 | Marketingu Ndërkombëtar | 6 |
| | | | **Total ECTS** | **10** |
| | | | **Total ECTS (Kategori A+B)** | **129** |
| **C** | **Lëndë Ndërdisiplinore/Integruese, Profilizuese, me zgjedhje (12-15%) (21.6 -27 ECTS)** | 1 | E Drejtë Biznesi | 6 |
| | | 2 | Matematike e Aplikuar | 6 |
| | | 3 | Lëndë me zgjedhje*** | 5 |
| | | 4 | Lëndë me zgjedhje*** | 5 |
| | | | **Total ECTS** | **22** |
| D | **Lëndë Plotësuese (10-15%) (18 -27 ECTS)** | 1 | Anglishtja e Përgjithshme | 4 |
| | | 2 | Hyrje në Informatikë | 4 |
| | | 3 | Praktika Profesionale/Seminar Special | 15 |
| | | | **Total ECTS** | **23** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **E** | **Detyrime Përmbyllëse (3-5%) (5.4 - 9 ECTS)** | | Temë Diplome/ Provim i Përgjithshëm Përfundimtar | **6** |
| **Gjithsej 29 Lëndë** | | | **Profili Marketing Total ECTS** | **180** |

* Nga lëndët e renditura në grupin prej renditjes 15 deri në 20, të cilat janë lëndë që ofrohen në vitin e tretë, për çdo vit akademik do të ofrohen vetëm 2 prej tyre. Kjo përcaktohet në planet mësimore që përgatiten çdo vit akademik, ku njësitë bazë përgjegjëse për këtë program studimi përcaktojnë lëndët që do të ofrohen duke pasur parasysh edhe lëndët që do të ofrohen në programet master të fakultetit Administrim Biznesi.

** Çdo student do të kryejë dy lëndë nga kjo kategori.

*** Si lëndë me zgjedhje, përveç lëndëve karakterizuese të këtij programi e të këtij profili, do të shërbejnë edhe lëndët karakterizuese të dy profileve të tjera. Njera nga këto lëndë me zgjedhje mund të jetë edhe nga programi Bachelor "E drejtë Biznesi"

**Neni 6**
**Lëndët dhe veprimtarite e tjera formuese**

a) Numri i veprimtarive formuese është 33 ku janë parashikuar 29 lëndë (dhe provime), 3 raporte praktike dhe tema e diplomës, ose provimi i përgjithshem përfundimtar.

**b)** Lëndët janë ndarë në katër grupe kryesore: (A) lëndë bazë - 5 lëndë: (B) lëndë karakterizuese të programit dhe të profilit - 18 lëndë; (C) lëndë ndërdisiplinore/integruese - 4 lëndë; (D) lëndë plotësuese – 2 lëndë dhe praktika profesionale. Lëndët karakterizuese, kategoria B, janë ndarë në lëndë karakterizuese të programit Administrim Biznesi, dhe lëndë karakterizuese të profilit përkatës. Në strukturën e veprimtarive formuese për secilin profil kjo ndarje është e evidentuar.

**Neni 7**
**Plani mësimor**

Plani mësimor indikativ që pasqyron periudhën kohore të organizimit të secilës disiplinë dhe veprimtari formuese të programit, ngarkesën e tyre në ECTS, orë në auditor dhe orë pune individuale të ndara në semestra, është dhënë në Aneksin A për secilin profil të këtij programi studimi.

**Neni 8**
**Fleksibiliteti i Strukturës dhe planeve mësimore**

Planet mësimore të paraqitura në nenin 7 më sipër, mund të përshtaten çdo vit akademik në përputhje me propozimet e njësive bazë dhe aprovohen nga Rektori. Gjithashtu këto plane mësimore përshtaten edhe në përputhje me nenet 6,7, 12 dhe 32 të Rregullores për Programet Studimit dhe Procesin Mësimor.

**Neni 9**
**Praktikat mësimore**

Organizimi dhe zhvillimi i trajnimit praktik/punësimit bëhet sipas procedurave të përcaktuara në Rregulloren për Programet e Studimit dhe Proçesin Mësimor dhe Rregulloren për Praktikën Mësimore.

**Neni 10**
**Kontrolli i dijes dhe sistemi i vlerësimit**

Rregullat për zhvillimin e procesit mësimor, kontrollin e dijes dhe sistemin e vlerësimit janë te përcaktuara me detaje në nenet 14-23 të Rregullores për Programet e Studimit dhe Procesin Mësimor.

**KREU III**

## PRANIMI I STUDENTËVE DHE AFATET E STUDIMIT

### Neni 11
### Kriteret dhe Proçedura e Pranimit të Studentëve

a) Programi i studimeve të ciklit të parë Bachelor në Administrim Biznes është program i hapur për të gjithë ata studentë që zotërojnë të paktën një diplomë të shkollës së mesme, shqiptare ose të huaj, sipas standardit dhe rregullave të vendosura nga MASR, si dhe për studentët me transferim.

b) Përpara fillimit të rregjistrimeve të çdo viti akademik Njesitë Bazë përgjegjëse per Programin e Studimit përcaktojne edhe kritere të veçanta të cilat miratohen nga Rektori i TBU.

### Neni 12
### Afati i studimeve

a) Kohëzgjatja normale e studimeve në programin e studimit Bachelor në Administrim Biznes me kohë të plotë është 3 vite akademike.

b) Në çdo rast studenti nuk mund të zgjasë studimet përtej dyfishit të afatit zyrtar të programit të studimit përveç rasteve kur ai ka pezulluar studimet ashtu si përcaktohet në Rregulloren për Programet e Studimit dhe Proçesit Mësimor.

## KREU IV
## VLERËSIMI ME KREDITE

### Neni 13
### Krediti dhe llogaritja e tij

Kreditet për çdo modul përcaktojnë ngarkesën në orë mësimore në auditor si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara nga programi. Ne tabelen me poshte eshte dhene ndarja ne ore ne auditor dhe ore pune individuale, që është përdorur si rregull për cdo një kredit për këtë program studimi.

| 1 kredit (ECTS) = 25 orë punë në total |
|---|
| Orë në auditor = rreth 10 orë<br>Orë punë individuale = rreth 15 orë<br>(Detyra shtëpie, Punë në grup, Provime të pjesshëm, Provimi final) |

## KREU V
## VLERËSIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT

### Neni 14

**Sigurimi dhe vlerësimi i cilësisë**

a) Rezultatet dhe niveli cilësor i aktiviteteve formuese të zhvilluara në programin e studimit të ciklit të parë "Bachelor në Administrim Biznes" vlerësohen çdo vit në përfundim të programit nga Njësia e Brendshme e Vlerësimit të Cilësisë

b) Vlerësimi shërben si bazë për vazhdimësinë e programit të studimit dhe përmirësimin e tij në vite.

c) Grupi i vlerësimit të brendshëm mbledh të gjithë informacionin e duhur për përgatitjen e raportit të vlerësimit të brendshëm.

## KREU VI
## DISPOZITA TË FUNDIT

### Neni 15

a) Kjo rregullore mund të përsoset e korrigjohet në përputhje me zhvillimet dhe detyrat e reja që merr përsipër programi Bachelor në Administrim Biznes.

b) Të drejtën e interpretimit të kësaj Rregulloreje e ka Dekani i Fakultetit Administrim Biznesi dhe Rektori.

*****

ANEKSI A

**PLANI MËSIMOR I PROGRAMIT BACHELOR ADMINISTRIM BIZNESI, PROFILI MENAXHIM, KONTABILITET-FINANCE DHE MARKETING**

| PLANI MESIMOR I PROGRAMIT BACHELOR ADMINISTRIM BIZNESI, TË TRE PROFILET | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| SEMESTRI | Nr. | Lendet | Kategoria e vep.formuese | ECTS | Leksione | Seminare | Javë gjithsej | Leksione Gjithsej | Seminare Gjithsej | Total orë në auditor | Orë pune individuale |
| SEMESTRI I | 1 | Matematikë e Përgjithshme | C | 6 | 2 | 2 | 15 | 30 | 30 | 60 | 90 |
| | 2 | Matematikë e Aplikuar | A | 6 | 2 | 2 | 15 | 30 | 30 | 60 | 90 |
| | 3 | Hyrje në Informatikë | A | 4 | 2 | 1 | 15 | 30 | 15 | 45 | 55 |
| | 4 | Software Aplikative | A | 5 | 2 | 1 | 15 | 30 | 15 | 45 | 80 |
| | 5 | Hyrje në Biznes | B | 5 | 2 | 1 | 15 | 30 | 15 | 45 | 80 |
| **Total semestri I** | | | | **26** | **10** | **7** | 15 | **150** | **105** | **255** | **395** |
| SEMESTRI II | 6 | Statistikë e Përgjithshme | A | 6 | 2 | 2 | 15 | 30 | 30 | 60 | 90 |
| | 7 | Statistikë e Aplikuar | A | 6 | 2 | 2 | 15 | 30 | 30 | 60 | 90 |
| | 8 | Anglishtja e Përgjithshme | D | 4 | 2 | 1 | 15 | 30 | 15 | 45 | 55 |
| | 9 | Anglishtja e Biznesit | B | 5 | 2 | 1 | 15 | 30 | 15 | 45 | 80 |
| | 10 | Komunikim profesional dhe akademik | A | 10 | 3 | 3 | 15 | 45 | 45 | 90 | 160 |
| | 11 | Praktikë Profesionale | D | 3 | | | | | | | 75 |
| **Total Semestri II** | | | | **34** | **11** | **9** | **15** | **165** | **135** | **300** | **550** |
| **Total Viti I** | | | | **60** | | | **30** | **315** | **240** | **555** | **945** |
| SEMESTRI III | 1 | Parimet e kontabilitetit | B | 6 | 2 | 2 | 15 | 30 | 30 | 60 | 90 |
| | **2** | Hyrje në Financë | B | 5 | 2 | 1 | 15 | 30 | 15 | 45 | 80 |
| | 3 | Kontabilitet Drejtim Kosto | B | 6 | 2 | 2 | 15 | 30 | 30 | 60 | 90 |
| | 4 | Menaxhim Financiar | B | 5 | 2 | 1 | 15 | 30 | 15 | 45 | 80 |
| | 5 | Mikroekonomi | B | 5 | 2 | 1 | 15 | 30 | 15 | 45 | 80 |
| **Total semestri III** | | | | **27** | **10** | **7** | **15** | **150** | **105** | **255** | **420** |
| SEMESTRI IV | 6 | Bazat e Marketingut | B | 5 | 2 | 1 | 15 | 30 | 15 | 45 | 80 |
| | 7 | Sjellja Organizative | B | 5 | 2 | 1 | 15 | 30 | 15 | 45 | 80 |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 8 | Menaxhim i Burimeve Njerëzore | B | 5 | 2 | 1 | 15 | 30 | 15 | 45 | 80 |
| | 9 | Menaxhim I Sistemeve të Informacionit | B | 6 | 2 | 2 | 15 | 30 | 30 | 60 | 90 |
| | 10 | Makroekonomi | B | 5 | 2 | 1 | 15 | 30 | 15 | 45 | 80 |
| | 11 | Administrim Fiskal | B | 5 | 2 | 1 | 15 | 30 | 15 | 45 | 80 |
| | 12 | Praktikë Profesionale | D | 4 | | | | | | | 100 |
| **Total semestri IV** | | | | **35** | **12** | **7** | **15** | **180** | **105** | **285** | **590** |
| **Total Viti II** | | | | **62** | | | **30** | **330** | **210** | **540** | **1010** |
| **SEMESTRI V** | 1 | Lëndë Karakterizuese e programit AB nr.1* | B | 6 | 2 | 2 | 15 | 30 | 30 | 60 | 90 |
| | 2 | Lëndë Karakterizuese e programit AB nr.2* | B | 6 | 2 | 2 | 15 | 30 | 30 | 60 | 90 |
| | 3 | E Drejtë Biznesi | C | 6 | 2 | 2 | 15 | 30 | 30 | 60 | 90 |
| | 4 | Lëndë Karakterizuese e Profilit nr.1 ** | B | 5 | 2 | 1 | 15 | 30 | 15 | 45 | 80 |
| | 5 | Lëndë me Zgjedhje nr. 1 | C | 5 | 2 | 1 | 15 | 30 | 15 | 45 | 80 |
| **Total semestri V** | | | | **28** | **10** | **8** | **15** | **150** | **120** | **270** | **430** |
| **SEMESTRI VI** | 6 | Sipërmarja dhe Menaxhimi i Biznesit të vogël | B | 6 | 2 | 2 | 15 | 30 | 30 | 60 | 90 |
| | 7 | Lëndë Karakterizuese e Profilit nr. 2** | B | 5 | 2 | 1 | 15 | 30 | 15 | 45 | 80 |
| | 8 | Lëndë me Zgjedhje nr. 2 | C | 5 | 2 | 1 | 15 | 30 | 15 | 45 | 80 |
| | 9 | Praktikë Profesionale | D | 8 | | | | | | | 200 |
| | 10 | Temë diplome/Provimi i përgjithshem përfundimtar | **E** | 6 | | | | | | | 150 |
| **Total semestri VI** | | | | **30** | **6** | **4** | **15** | **90** | **60** | **150** | **600** |
| **Total Viti III** | | | | **58** | | | **30** | **240** | **180** | **420** | **1030** |
| **TOTAL Programi Bachelor AB** | | | | **180** | | | **90** | **885** | **630** | **1515** | **2985** |

*** Këto lëndë do të zgjidhen nga lëndët e renditura në grupin prej renditjes 15 deri në 20, në grupin e lëndëve karakterizuese të programit të paraqitura në strukturë e veprimtarive formuese për secilin profil.**

**** Lëndët Karakterizuese të secilit profil janë paraqitur në Tabelat e Veprimtarive Formuese të programit Bachelor në Administrim Biznesi, për profilin specifik.**